



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE**

**NJOFTIM**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga shoqëritë Med Lab SHPK, Evita SHPK dhe FARMACOM SHPK.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 125 prot., datë 29.01.2024 “Kërkohet autorizimi për miratimin e “Marrëveshjes për Shit-blerjen e Kuotës”, datë 19.04.2024 lidhur ndërmjet shoqërisë “MED LAB” SHPK dhe Z. Ben Petani për shit-blerjen e Kuotës që përfaqëson 33.34% (tridhjetë e tre pikë tridhjetë e katër përqind) të kapitalit të shoqërisë “Pharma One” SHPK”, ku jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e shitblerjes së kuotës tek shoqëria Med Lab SHPK, që z. Ben Petani zotëron në shoqërinë PHARMA ONE SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga pala njoftuese, palët në transaksion janë:

**Pala Blerëse: Med Lab SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti shitje-blerje të pajisjeve mjekësore e laboratorike, investime në fushën e laboratorëve mjekësore; import, eksport, tregtim me shumicë e pakicë, montim e riparim i aparaturave laboratorike mjekësore etj.

Referuar pasqyrave financiare të shoqërisë për vitin 2022 rezulton se shoqëria nuk ka kryer aktivitet ekonomik dhe nuk ka realizuar të ardhura.

**Shoqëria target: PHARMA ONE SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e angazhuar në fushën e tregtisë ku do të kryejë tregtimin me shumicë dhe pakicë të barnave dhe pajisjeve mjekësore dhe artikujve farmaceutikë, lëndëve të para, aksesorë, para farmaceutike, tregtimin dhe import-eksportin e mallrave të ndryshme si pajisje mjekësore industriale e artikujve të ndryshme, elektrike, mekanike etj.

**Pala Shitëse: z. B. P.** shtetas shqiptar, person fizik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**